

Termat e Referencës (ToR) Për shërbime – kontraktim individual

Informatat e përgjithshme			
Përshkrimi I punës/shërbimit	Dy (2) Ekspert për të Udhëhequr Punëtoritë mbi Çështjet që Lidhen me të Drejtat Pronësore		
Titulli I Projektit/Programit	PIAKOS		
Pozita	Ekspert		
Niveli i konsulentit:	Senior/Ekspert		
Lokacioni:	Prishtinë, Kosovë		
Kohëzgjatja e angazhimit:	18 ditë pune për Ekspert (Gusht 2024- Korrik 2025)		
Data e kërkesës:	01 gusht 2024	Afati i fundit për aplikim	11 Gusht 2024
Data e planifikuar e fillimit:	20 Gusht 2024		
Autoriteti kontraktues:	Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ)		

I. Hyjre

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) është një organizatë profesionale e themeluar në vitin 2008, e dedikuar për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë. Misioni kryesor i KLGJ-së është të lehtësojë reformat në qeverisjen lokale dhe të avancojë sistemin e qeverisjes së decentralizuar. Kjo përfshin promovimin e demokracisë lokale, rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal dhe shoqërisë civile lokale, dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve komunale për qytetarët. KLGJ vendos një theks të fortë në angazhimin qytetar, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në qeverisjen lokale dhe proceset vendimmarrëse. Duke promovuar një kulturë të përgjegjësisë qytetare dhe përfshirjes, KLGJ synon të krijojë një qeverisje lokale më përfshirëse dhe më të përgjegjshme. Përveç kësaj, KLGJ fokusohet në konsolidimin demokratik dhe zhvillimin e politikave lokale të frymëzuara nga modelet e avancuara evropiane dhe rajonale.

KLGJ angazhohet në një gamë të gjerë aktivitetesh, duke përfshirë hulumtimin, avokimin, rrjetëzimin, këshillimin politik dhe programet e avancuara të ndërtimit të kapaciteteve. Spektri i mbështetjes së organizatës shtrihet në nivele dhe aspekte të ndryshme të qeverisjes, duke përfshirë nivelet e qeverisjes lokale dhe qendrore, organizatat e komunitetit, hartimin e legjislacionit, ndërtimin e kapaciteteve për nëpunësit civil, dialogun ndër-institucional, harmonizimin e politikave dhe qartësimin e kompetencave dhe detyrimeve. Këto përpjekje janë të drejtuara drejt përmirësimit të ndërveprimit ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes.

II. Rreth projektit dhe qëllimi i angazhimit

Projekti Nisma për të Drejtën e Pronës (NDP), zbatohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), bashkë-zbatuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe financuar nga Banka Botërore/Fondi për Paqe dhe Shtet-Ndërtim. NDP, synon të adresojë nevojën kritike për përmirësimin e qasjes në informacionin për regjistrimin e tokës dhe pronës, si dhe ofrimin e shërbimeve të këshillimit në lidhje me të drejtat pronësore për gratë, të rinjtë dhe personat e cenueshëm në Kosovë.

Aktivitetet e projektit do të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqësor, duke ndihmuar komunitetet me dokumentacionin e nevojshëm dhe të mbështetur ligjrisht për forcimin e sigurisë së të drejtave mbi tokën/pronën, duke ofruar një mundësi për pjesëmarrjen e tyre në ekonominë më të gjerë dhe duke vendosur bazat për një shoqëri më të barabartë.

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) si bashkë-zbatuese e projektit NDP, në kuadër të këtij projekti do të organizojë tre lloje aktivitete:

1. Punëtori me stafin përkatës komunal për të lehtësuar zbatimin e legjislacionit në lidhje me të drejtat pronësore. KLGJ do të organizojë një punëtori për komunë (14 punëtori gjithsej).
2. Punëtori me përfaqësuesit e këshillave lokale për t'i inkurajuar ata të mbështesin komunitetet e cenueshme për çështjet që lidhen me të drejtat pronësore. KLGJ do të organizojë një punëtori për çdo komunë (14 punëtori gjithsej).
3. Punëtori/Retreats/Fokus grup në komuna me të gjitha grupet e cenueshme në temën e regjistrimit të pronës (12 punëtori gjithsej).

Prandaj, KLGJ kërkon të angazhojë dy (2) ekspert të kualifikuar për të udhëhequr punëtori në lidhje me të drejtat e pronësisë. Këto punëtori synojnë të ofrojnë një pasqyrë të thelluar dhe praktike mbi zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë të drejtat e pronësisë, duke përfshirë rastet specifike dhe çështjet që hasen më shpesh në praktikë.

III. Detyra e punës

Eksperti (konsulenti) duhet të analizojë materialet ekzistuese për të drejtat pronësore dhe rrugët ligjore për realizimin e kësaj të drejte dhe të hartojë materialin e trajnimit për me stafin përkatës komunal mbi rëndësinë e regjistrimit të pronave dhe të mirat që i sjellë regjistrimi. Eksperti (konsulenti) ka të drejtë të propozojë informatat të tjera për material trajnues për të cilën mendon se duhet të jenë pjesë e këtij materiali.

Eksperti (konsulenti) duhet të përgatisë materialin në bashkëpunim me Menaxherët e KLGJ-së, si dhe Menaxherët e PIAKOS, dhe ta dërgojë paraprakisht tek KLGJ dhe ATRC për aprovim para se të finalizohet. Eksperti (konsulenti) duhet të sigurohet që materiali i përdorur dhe i prodhuar nuk ka konflikt me kornizën ligjore dhe të drejtat e njeriut.

Eksperti duhet të mbajë përgjegjësi mbi përmbajtjen e materialit.

IV.

No.	Output	Kohëzgjatja	Kërkohe Rishikim dhe Aprovim
1	Drafti i parë i materialit mbi të drejtat pronësore për grupet e cenueshme në Kosovë	Më së largu deri më Gusht 2024	PO (nga KLGJ dhe ATRC)
2	Materiali përfundimtar (nëse ka kërkesë nga KLGJ dhe ATRC për ndonjë ndryshim eventual)	Me së largu deri më Gusht 2024	PO (nga KLGJ dhe ATRC)

3	Udhëheqja e punëtorive	Me së largu deri më Shtator 2024- Qershor 2025	PO (nga KLGJ)
4	Draftimi i raportit rreth angazhimit	Më së largu deri më Korrik 2025	PO (nga KLGJ dhe ATRC)

V. Kohëzgjatja

- a. Kohëzgjatja: **Gusht 2024- Korrik 2025**
- b. Data e paraparë e fillimit të angazhimit **20 Gusht 2024.**

VI. Përvoja dhe Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë e avancuar në drejtësi, e preferueshme në të drejtën civile ose të drejtën pronësore.
- Të kenë përvojë minimale prej 8 vitesh në fushën ligjore, e preferueshme në fushë civile.
- Përvojë e dëshmuar në draftim ose hartim të manualeve në gjuhë miqësore për traqetin e specifikuar më lartë.
- Njohje e dëshmuar e praktikave dhe procedurave të aplikueshme në institucionet e Kosovës, të cilat trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronës.
- Përvojë e dëshmuar në analizimin dhe interpretimin e kuadrit ligjor, veçanërisht në kontekstin e pronës, trashëgimisë, procedurës civile, etj.

VII. Procedura dhe kriteret e përzgjedhura për këtë kontraktim

Procedura e përzgjedhur për këtë kontraktim është bazuar në marrëveshjen mes ATRC dhe KLGJ. Nenit 12 nën pjesën për kuotim të thjeshtëzuar.

Nr.	Kapaciteti Teknik dhe Financiar	Pikët
1	Dëshmi të eksperiencës së paku 8 vjecare në fushën e kërkuar	30
2	Metodologji e punës apo plani i punës	30
3	Oferta financiare	30
4	Referencat	10
Total pikët teknike * 60% + Total pikët financiare* 40%		100

VIII. Palët e interesuara duhet të dërgojnë këto dokumente:

- CV e cila përshkruan përvojën e punës në lëminë e kërkuar në këtë thirrje.
- Metodologji e punës apo plani i punës
- Shembuj nga materialet e ngjashme të zhvilluara.
- Çmimin e ofertës (tarifën ditore për angazhim në euro)
- Të ofrojnë më së paku një referencë për punë të ngjashme.

IX. Pagesa

Pagesa e parë do të bëhet pas aprovimit final të manualit, ndërsa pagesat tjera do të bëhen pas realizimit të çdo punëtorie.

X. Procedura e aplikimit:

Ekspertët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet e tyre të aplikimit në email: info@klgi-ks.com
Për çdo pyetje teknike apo paqartësi, ju lutemi na kontaktoni në email: info@klgi-ks.com